



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 3.7.2015,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Blerand Stavileci (PDK) dhe Shaip Shabani (PDK).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të kompanisë së ujësjellësit rajonal (KUR) “Prishtina” NPL.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të fillonin me rendin e ditës, **Lirak Çelaj** propozoi që pikat: tre (3), katër (4) dhe pesë (5), të hiqen nga rendi i ditës dhe të mos diskutohen, derisa nuk ndërrohet drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Liburn Aliu. Po ashtu edhe pikat: gjashtë (6) dhe shtatë (7) të hiqen nga rendi i ditës, për shkak se ekzekutivi për këtë çështje përsëri i ka shpërfillur kërkesat e Kuvendit.

Për rendin e ditës diskutuan Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Flamur Shala, Mirlinda Sopi dhe Muhamet Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Lidhur me rendin e ditës, **Shpend Ahmeti**, Kryetari i Komunës, tha se tashmë e kemi një situatë e cila tash e një kohë po mbizotëron në Kuvendin e Komunës, ku çështjet më të rëndësishme që janë në interes të qytetarëve, kanë stagnuar dhe nuk po procedohen më tutje. Po ashtu nuk po lejohet kalimi i legalizimit dhe dhënies në shfrytëzim të pronave sipas ligjit, për të ndaluar uzurpimet, të cilat janë bërë edhe prej disa njerëzve që janë këtu në Kuvendin komunal, duke e ndaluar kështu zhvillimin e Komunës së Prishtinës, me qëllime kryekëput personale dhe politike.

Ne si ekzekutiv i kemi kompetencat tona, do të vazhdojmë ta ushtrojmë detyrën tonë si ekzekutiv, do të vazhdojmë të japim leje në ato vende ku nuk ka plane rregulluese sipas Planit zhvillimor urban, do të vazhdojmë me të gjitha projektet të cila i kemi të përcaktuara me kompetencat e ekzekutivit. Arsyet të cilat janë dhënë për një incident, i cili ka ndodhur jashtë Kuvendit, për të cilin drejtori ka shprehur keqardhje, me të cilin rast po merren organet e rendit, jo që po merret Kuvendi komunal, por është dërguar edhe kallëzimi penal.

Derisa të bëhet funksional Kuvendi, ne si ekzekutiv nuk mund të qëndrojmë në sallë.

Kryesuesi pas mbarimit të diskutimeve, e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e tri (23) vota për dhe me njëzet e katër (24) vota kundër (**Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra- Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Lirak Çelaj, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi dhe Shemsi Veseli**), (sipas rendit të ditës të propozuar nga kryesuesi dhe kryetari) hiqen pikat: - **Propozimvendimi për miratimin-lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria"**, - **Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1"**, - **Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë**, - **Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe - Propzimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, hiqen nga rendi i ditës.**

Pas miratimit të rendi të ditës, Kryetari me ekzekutivoin e Komunës dhe përfaqësuesit e subjektit politik të LVV-së, përfaqësuesit e subjektit politik të AAK-së, përfaqësuesit e subjektit politik të PD-së-, përfaqësuesit e subjektit politik të LB-së, përfaqësuesin e subjektit politik GIS dhe përfaqësuesin e subjektit politik të KDTP-së, e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

R E N D D I T E:

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë;**
2. **Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015;**
3. **Propozimrregullorja për rrugët komunale;**
4. **Propozimrregullorja për organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore;**
5. **Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër NPL "Hortikultura";**
6. **Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të Komunës së Prishtinës, Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës;**
7. **Informatë për gjendjen e furnizimit me ujë KUR "Prishtina" NPL;**
8. **Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;**
9. **Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve;**
10. **Pyetje dhe përgjigje;**
11. **Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë.

Lirie Avdiu bëri vërejtje në ekstrakt rreth mënyrës së votimit, e cila tha se vota ime, e Laura Zherkës dhe e Lirijeta Rexhepit nuk kanë qenë *për*, siç është paraqitur në ekstrakt, por kanë qenë *abstenim*, andaj kërkojmë që kjo të korrigjohet.

Kryesuesi konstatoi se, me vërejtjen e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015;

Kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Lidhur me popozimvendimin diskutuan Sami Hamiti, Lirak Çelaj dhe Remzi Pacolli.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e shtatë (27) vota për, u miratua Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015.

Pika e tretë dhe e katërt

Propozimrregullorja për rrugë komunale dhe Propozimrregullorja për organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këto pika të rendit të ditës.

Sami Hamiti tha se është mirë që këto rregullore në parim të shkojnë në diskutim publik, të jepen vërejtjet, pastaj të kthehen për shqyrtim në Kuvend.

Lidhur me propozimrregulloret diskutuan edhe Shemsi Veseli, Lirie Avdiu, Agim Gashi, Sofije Bunjaku dhe Remzi Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas mbarimit të diskutimeve, **Kryesuesi** i hodhi në votim propozimrregulloret.

- **Kryesuesi konstatoi se me njëzet e shtatë (27) vota për, u miratua lënia në diskutim publik e Propozimrregullores për rrugët komunale.**
- **Kryesuesi konstatoi se me njëzet e tetë (28) vota për, u miratua lënia në diskutim publik e Propozimrregullores për organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore.**

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër NPL "Hortikultura".

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Sami Hamiti tha se realisht ky vendim nuk mundet të kalojë, sepse ne nuk jemi kompetent të vendosim për prona të cilat nuk janë në menaxhimin dhe administrimin e Komunës, andaj kjo pikë duhet të hiqet nga rendi i ditës.

Agim Gashi theksoi se nuk është shumë e qartë çka kërkon Hortikultura në këtë pronë, apo formulimi është i tillë që lë mundësi për të mos u kuptuar drejt. Ky Kuvend para disa vitesh ia ka dhënë një parcelë Hortikulturës dhe deri më sot nuk e ka shfrytëzuar, andaj do të ishte mirë ta shfrytëzojë atë sipërfaqe të cilën ne ia kemi dhënë, aty te objekti ku e ka bazën, prej 1 hektarë tokë.

Kryesuesi pas mbarimit të diskutimeve, e hodhi në votim propozimvendimin. **Kryesuesi konstatoi se me një (1) votë për, njëzet e tri (23) kundër (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Lirak Çelaj, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi dhe Shemsi Veseli) dhe tri (3) abstenime (Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku dhe Remzi**

Pacolli), nuk u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër NPL "Hortikultura".

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të Komunës së Prishtinës, Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të Komunës së Prishtinës, Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës.

Pika e shtatë

Informatë për gjendjen e furnizimit me ujë KUR "Prishtina" NPL.

Lidhur me informatën për gjendjen e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës, të pranishmit i informoi Gjelosh Vataj, kryeshef ekzekutiv i KUR "Prishtina" NPL.

Për gjendjen e furnizimit me ujë, diskutuan Lirak Çelaj, Shaip Hajrizi, Agim Gashi, Visar Arifaj, Sokol Krasniqi, Sofije Bunjaku, Shefki Gashi, Sami Hamiti, Islam Pacolli, Ajnishahe Azemi, Merita Surkishi dhe Shemsi Veseli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për gjendjen e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës.

Pika e tetë dhe e nëntë

Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës dhe Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve.

Kryesuesi propozoi që këto dy pika të rendit të ditës të shtyhen për diskutim për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Pika e dhjetë

Pyetje dhe përgjigje.

Agim Gashi, pyetje për Kryetarin e Komunës.

Pavarësisht a kemi marrë përgjigje, a nuk kemi marrë, në seancën e kaluar kam shtruar pyetjen për Kryetarin e Komunës, që në objektet e Komunës së Prishtinës, siç është objekti në rrugën "Luan Haradinaj", pastaj në lagjen "Arbëria" dhe në objektet tjera, nuk shihet flamuri shtetëror i Kosovës mbi portat e objekteve.

Po ashtu, me rastin e shënimit të festave të ndryshme dhe ngjarjeve të rëndësishme, flamuri shtetëror vazhdon të mos përdoret nga qeveria komunale dhe shërbimet përkatëse.

- Kryetari dhe stafi i tij, kur do të pushojnë së shkeluri Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore?

Për pyetjet e parashtruara nuk kam marrë përgjigje, prapë e përsëris dhe e adresoj për Kryetarin e Komunës dhe ekzekutivin:

-Kur do të pushojë kjo qeverisje në shkeljen e Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore?

Islam Pacolli ngiti çështjen lidhur me ndërtimin e një rruge në fshatin Hajvali, i cili tha se kemi pasur shumë kërkesa që të rregullohet ajo rrugë, por jo një garanci që nuk do të kenë probleme gjatë realizimit të projektit. Po ashtu vlen të veçohet edhe problemi rreth kyçjes së banorëve në rrjetin e kanalizimit. Këtë projekt ne e përkrahim, por me një memorandum zyrtar, për arsye që edhe salla e sportit sot që është duke u ndërtuar në Hajvali, është me projektin e kompanisë sonë dhe kur janë shpërndarë falënderimet apo mirënjohjet, kompania jonë nuk është përmendur fare. Kështu që ne duhet me qenë të singertë, sado që të jenë për atë kontribut, duhemi me qenë mirënjohës.

Muhamet Selmani, pyetje për Drejtorinë e Arsimit.

Në mbledhjen e kaluar kam bërë një pyetje rreth zgjedhjes së drejtorit në SHF "Ali Kelmendi" në Barilevë. Lidhur me këtë kam marrë një përgjigje nga drejtorja, por nuk janë sqaruar të gjitha detajet rreth zgjedhjes së drejtorit. Kërkoj zyrtarisht të gjithë dokumentacionin e zhvillimit të këtij procesi.

Vlora Dumoshi, pyetje për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Si GP i LDK-së, kërkojmë një raport të thukët të projekteve, sidomos të subvencioneve dhe aktiviteteve të cilat po zhvillohen nga kjo drejtori.

Flamur Shala ngriti një shqetësim, duke thënë se jemi dëshmitarë të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të disa punëtorëve të Komunës, të cilëve Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës vendimin ua ka kthyer pozitiv.

Kërkojmë që të na sillen një listë e punëtorëve të cilëve po u ndërpritet marrëdhënia e punës, dhe për të cilët ka marrë vendim Këshilli i Pavarur që të kthehen në punë, dhe një listë të punëtorëve të cilët po punësohen me kontratë mbi vepër.

Shaip Hajrizi paraqiti kërkesën e disa banorëve të fshatit Llukar, gjegjësisht afër pompës së benzinës "Nasa Petroll", të cilët janë të rrezikuar nga shembja e dheut, që kërkojnë nga Komuna të merren masa urgjente për sanimin e gjendjes së krijuar, e cila paraqet një rrezik permanent për jetën e atyre banorëve.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, kërkoi që për mbledhjen e ardhshme të jetë një debat lidhur me Raportin e auditimit gjeneral, faktikisht që është edhe obligim ligjor. Nëse në mbledhjen e ardhshme përsëritet pika - **Informatë për shfrytëzimin e hapësirës publike**, kërkoj që neve këshilltarëve të na jepet në posedim kartela e kontos, për ta ditur se kush po i shfrytëzon hapësirat publike.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.